

RASA EMËRORE DHE RASAT E MIRËFILLTA

SIPAS SELMAN RIZËS

Sala AHMETAJ
Prishtinë

Punim studimor

Selman Riza, studiues i thelluar në disa disiplina gjuhësore, është një emër i veçantë i gjuhësisë shqiptare. Njohës të jetës e të veprës së tij e kanë cilësuar si atdhetar të papërkulur. Fenomeni Riza, siç e cilëson akademik Rexhep Ismajli, ishte njëri nga gjuhëtarët dhe dijetarët e të shquar, për të cilin Gramatika dhe Kosova ishin pasionet dhe dashuritë e tij të pandashme, ishin metaforat e dijes dhe atdheut. Ai synonte konceptimet teorike e filozofike të njohjes, të intelektologjisë e të komunikativistikës dhe në çdo fushë solli rezultate të dalluara, të cilat shquajnë individualitetin dhe mendjen e tij krijuese e rrezatuese.

Vlerësimi për veprën e tij nuk është i lehtë sa për thellësinë po aq për gjerësinë që ka. Pra, është i vështirë sidomos për ata që nuk janë në lartësinë shkencore të tij. Ai ishte i veçantë për emancipimin dhe avancimin e kriterëve në analizën e njësive gjuhësore me synimin që studimet shqiptare t'i çonte në nivelin teorik evropian. I veçantë për objektivitetin e rreptësi shkencore, përkufizim të koncepteve dhe termave. Mjafton të përmendim monografinë e tij për emrat e shqipes dhe sistemin e rasave, për analizat e tij që nisin nga konceptimet semantike dhe funksionale kur shtjellonte sintagma emërore etj. Në monografi (në pjesën e saj qendrore), kur shqyrtohet sistemi i rasave dhe tipat e lakimit, ai, konceptin e rasës e sheh në rend të parë si marrëdhënie midis emërores dhe rasave të mirëfillta, ashtu si edhe kuptimin e funksionin e rasës emërore dhe të rasave të tjera, të mirëfillta, si

parapëlqen t'i quajë S.Riza rasat gjinore, dhanore dhe kallëzore. Shtjellimin të tyre, ai e fillon me një qasje polemizuese rreth përkufizimeve dhe vlerësimeve të dhëna nga Shqerba e Vinogradovi, të cilët pohonin se rasa emërore njëjës përbën fjalën, ndërsa të gjitha rasat tjera përbëjnë variacionet e saj. Ata pohonin gjithashtu se rasa emërore është formë si gjithë të tjerat por vetëm funksioni i saj *quajtës* (emërues) e bën atë përfaqësuese të tërë grupit të formave që së bashku përbëjnë një fjalë të vetme (S. Riza, vepra 3, 2002:44). Riza nuk pajtohet me këto pohime e konstatime për statusin e emërores si përfaqësuese dhe si funksion quajtës duke dhënë argumentet bindëse se të dhënat, fjala vjen për fjalën *atë* dhe derivatet *atësi*, *atëror*, përbëjnë jo një fjalë, por familjen e fjalës. Po ashtu edhe te format *atë*, *etër*, *etërve*, përbëjnë jo një fjalë të vetme, por një paradigmë formash të së njëjtës fjalë (*atë*).

Kundërargumenti tjetër për funksionin *quajtës* të emërores është se funksioni quajtës nuk i takon ekskluzivisht rasës emërore, por u takon të gjitha rasave, sepse funksioni quajtës nuk është asgjë më shumë sesa kuptimi leksikor i fjalës përkatëse që në rasat e zhdrejta shfaqet nga morfema temë: “Larg së qeni një formë e një emri si gjithë format tjera të këtij emri, emërorja njëjës e një emri është përkundrazi forma bazale e mbarë lakimit të këtij emri” (S. Riza 2002:44), sepse, sipas Selman Rizës, formën bazale të mbarë lakimit të një emri e përbën pikërisht vetë emri, i marrë jo në shtyllën e fjalorit, por në gjirin e ndonjë fjalie, pra në kuadër të ndonjë strukture gjuhësore ose një konteksti gjuhësor sipas nesh. Kjo mund të argumentohet edhe me faktin se emri brenda shtyllës së fjalorit synon të lidhet vetëm me vetveten, të shfaqë vetën neutrale, jashtë ligjëritimit gjuhësor dhe pa funksion sintaksor. Kurse në strukturën e një fjalie, në një kontekst të caktuar, emri synohet edhe me format e tij jo bazale, me format të cilat i merr në rasat e mirëfillta (gjinore, dhanore, kallëzore). Emërorja si rasë quhet jo e mirëfilltë për faktin se është formë bazale dhe formë përfaqësuese në fjalor që e relativizon funksionin sintaksor duke u parë vetëm si element gjuhësor.

Por, kur emri “synohet” jo në shtyllën e fjalorit, por në gjirin e një fjalie, është e vërtetë se emri në emëroren njëjës kalon *ipso facto* nga skematizmi kuptimor e indiferentizmi funksional i fjalorit në konkretizimin kuptimor dhe diferencimin funksional në kuadër të fjalisë.

Kur shpjegohen kuptimet e rasave dhe funksionet e tyre gramatikore, në të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe pohohet se emri në rasën emërore kryen së pari funksionin e kryefjalës, se është fjala kryesore në fjali dhe se është fjala gramatikisht e pavarur. Këto pohime, konsideroj se duhet të

merren me rezervë, në të vërtetë duhet të përfillet teoria funksionaliste, sipas së cilës, në kuadër të një fjalie ose të një fragmenti ligjërimor folja është qendra organizuese që mundëson, kufizon, kushtëzon ose lejon daljen e ndonjë gjymtyre tjetër. Ajo, pra, ua hap vendin dhe ua krijon hapësirën fjalëve të tjera, prandaj, edhe emrit në rasën emërore, që del si “sateliti” më i afërm i foljes dhe si gjymtyra që ka status special, por që nuk është e pavarur gramatikusht, dhe as fjala kryesore, por që bashkë me emrin në kallëzore janë fjalë dhe gjymtyrë të shumtën e herës të domosdoshme për kallëzuesin, ua hap vendin dhe ua krijon hapësirën fjalëve të tjera, prandaj duhet ta cilësojmë si një formë të veçantë të funksionit kryesor gramatikor, për dallim nga gjymtyrët e tjera që më shpesh dalin si fakultative ose si entitete të përfshira në veprim.

Për të mbështetur pikëpamjet tona rreth statusit të gjymtyrëve, që i kemi thënë edhe në punimet e tjera, na vjen si mbështetje pohimi i Rizës (2002:45): “Pra raporti ekzistues midis kryefjalës dhe kallëzuesit pikënisjen e vet e ka jo tek kryefjala por tek kallëzuesi; kështu që nuk është kryefjala ajo që gjindet në raport me kallëzuesin, por anasjelltas është kallëzuesi ai që gjindet në raport me kryefjalën, e kështu që çfaqja e këtij raporti i takon formës jo të emrit kryefjalë por të foljes kallëzues”.

Këto pohime të thëna më lart nga autori dëshmojnë për faktin se emri në funksion kryefjale del me status jo të barabartë me foljen kallëzues. Sipas pikëpamjeve tona kryefjala dhe kundrinori pa parafjalë janë gjymtyrë parësore, në hierarki dhe në krahasim me kallëzuesin që është gjymtyrë kryesore dhe i cili me formën dhe përmbajtjen që ka bën licencimin e gjymtyrëve tjera, e edhe të kryefjalës dhe të kundrinorit të drejtë. Kallëzuesi në paraqitjen e tij asnjëherë nuk është redundant, sepse zgjedhja e shenjave gramatikore brenda këtyre kategorive nuk është e varur nga asnjë zgjedhje tjetër gramatikore në kuadër të së njëjtës strukturë të fjalisë. Derisa kryefjala për t’u shprehur ose paraqitur duhet të zgjedhë vetëm njëerën rasë (nga gjashtë sa ka gjuha shqipe) dhe atë me kushtëzim për përdorim pa parafjalë. Kurse kallëzuesi mund të dalë (me kategoritë gramatikore që ka) në secilën vetë, mënyrë dhe kohë. Kufizimi për kallëzuesin nuk del nga struktura gramatikore e fjalisë, por nga fakti çka do dikush të thotë dhe si do ta thotë. Përdorimi p.sh. i vetës së parë njëjës bëhet nëse duhet dhe kërkohet të thuhet se subjekt i atij predikati është vetë folësi, por në qoftë se nuk kërkohet të dihet subjekti, përdoret forma pa vetore e kallëzuesit. Prandaj shpjegimi më argumentues dhe i mbështetur është fakti se kryefjala del në emërore, por dalja në emërore e emrit kryefjalë nuk e justifikon pohimin se ajo është gjymtyra gramatikusht e pavarur sepse emri si njësi leksikore “e

pavarur” del në shtyllat e fjalorit në rasën emërore. Për faktin se emri në rasën emërore (në shtyllat e fjalorit) del si trajtë përfaqësuese jashtë lidhjeve sintaksore me fjalë të tjera, e shkëputur dhe pa ndonjë funksion dhe e pa lidhur me njësitë tjera. Emri në emërore në fjali, në funksion të kryefjalës nuk është i pavarur as gjymtyrë kryesore, sepse në kuadër të fjalisë dalja e tij në këtë rasë u kundërvihet rasave tjera dhe ka kushtëzime të caktuara nga forma dhe përmbajtja e kallëzuesit (sepse numri dhe veta janë kategori gramatikore të foljes). Gramatikanët tanë ende nuk e kanë pranuar teorikisht faktin se kallëzuesi është gjymtyrë kryesore sintaksore e fjalisë. Edhe pse ndonjëri pohon se në pamje të parë lidhja midis kryefjalës dhe kallëzuesit është lidhje varësie por në të vërtetë nuk është e tillë.

Kuptimi leksikor i emrit, mendoj se është i njëjtë në të gjitha rasat, kurse funksioni sintaksor del i ndryshëm, varësisht se në cilën rasë shfaqet emri ose në cilën fjali dhe në cilin kontekst përdoret. Kur shpjegohen kuptimet e ndryshme të rasave në gramatika jepen shpjegime se kuptimi kryesor i rasës emërore të emrit është shërbimi i saj sintaksor për të treguar kryefjalën. Për statusin e gjymtyrëve dhe funksionin e rasave, ndërkaq, mendoj se funksioni parësor i rasave është i kushtëzuar drejtpërsëdrejti nga raporti ose marrëdhënia që kanë ato me foljen, dhe edhe më qartë, nga forma, kuptimi dhe vlerat që ka një folje dhe si rrjedhim marrëdhënia në mes të emrit në rasën emërore në funksion të kryefjalës dhe kallëzuesit kushtëzimin dhe nisjen e ka te kallëzuesi e jo te kryefjala. Pohimin tonë e mbështesim tek studimet e shumta nga teoria e gjuhësisë së përgjithshme (Lyons, Martinet, Robins, Katiçiq, Bariq, Pollum etj.).

Si përfundim studimi teorik për rasën i Selam Rizës është një vlerë për të ndihmuar përkufizimin e gjymtyrëve, statusin dhe funksionin e tyre.

LITERATURA

Riza, Selman, *Vepra 3*, Prishtinë, 2002.

Ismajli, Rexhep, *Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*, Prishtinë, 2009.

Angoni, Engjëll, *Selman Riza gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*, Toena. Tiranë, 1999.

Shehu, Masar, *Kujtime për gjuhëtarin e papërkulur S. Riza*, “Rilindja”, Prishtinë, 1998.

Xholi, Zija, *Unë skllavi i S. Rizës*, “Albania”, Tiranë, 2001.

Dhima, Thoma, *Gjuha Shqipe – Sintaksa*, Tiranë, 2005.

Ahmetaj, Sala, *Gjymtyrimi i fjalisë*, “Gjuha Shqipe”, Prishtinë, 2000.

Haddleston, R., Pullum, G. K., *The Cambridge Grammer of the English Language*, Cambridge, 2002.

Katičić, R., *Sintaktičke studije, Jezikoslovno ogledi*, Zagreb, 1971.

Barić, Henrik, *Hrvatska gramatika*, Zagreb, 2005.

Martinet A., *Jezik i funkcija*, Sarajevë, 1973.

**NOMINATIVE CASE AND GENUINE CASES
ACCORDING TO SELMAN RIZA**

Summary

Selman Riza, a researcher immersed in several linguistic disciplines, is a special name in Albanian linguistics. Those who are familiar with his life and work have described him as a devoted patriot. The Riza phenomenon, as academician Rexhep Ismajli describes it, was one of the most prominent linguists and scholars, for whom grammar and Kosovo were his inseparable passions and loves, they were metaphors of knowledge and homeland. He aimed at the theoretical and philosophical conceptions of cognition, intellectology, and communication. In each field, he brought distinct results, which distinguish his individuality and his creative and radiant mind.